



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Dhuna Në Bazë Gjinore Ndaj Grave me Aftësi të Kufizuara



Dhuna Në Bazë Gjinore Ndaj Grave me Aftësi të Kufizuara

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e OJQ You Can Do dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PERMBLEDHJA

Globalisht, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë tre herë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë me bazë gjinore, nga familja, partnerët intimë, kujdestarët dhe institucionet, krahasuar me gratë që jetojnë pa aftësi të kufizuara. Megjithatë në shumë raste dhuna në bazë gjinore ndaj grave me aftësi të kufizuar mbetet e pa raportuar. Edhe në Kosovë rastet e dhunës në bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave janë të nen raportuara. Kjo përmbledhje e politikave analizon situatën aktuale, kornizën ligjore, dhe identifikon arsyet se pse gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara rrallë herë raportojnë dhunën. Përmbledhja përfundon me rekomandime konkrete ndaj institucioneve relevante.

HYRJA

Në Republikën e Kosovës jetojnë 28,611 persona me aftësi të kufizuara, të 58% e të cilëve janë gra dhe 42% burra. Personat me aftësi të kufizuar kanë shkallë më të lartë të papunësisë, të pasivitetit ekonomik si dhe të mungesës së mbështetjes sociale në krahasim me personat e tjerë.¹ Gratë me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim të dyfishtë, sepse ato jo vetëm që përjetojnë diskriminim në bazë gjinore, por gjithashtu hasin barriera dhe paragjyqime të bazuara në aftësinë e kufizuar, gjë që kufizon më tej qasjen e tyre në arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale edhe më tej. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë tre herë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë me bazë gjinore, nga familja, partnerët intimë, kujdestarët dhe institucionet, krahasuar me gratë që jetojnë pa aftësi të kufizuara.² Kryesit e dhunës në shumicën e rasteve janë anëtarët e familjes dhe kujdestarët. Në botë, 6 në 10 gra me aftësi të kufizuara mendore raportojnë se janë abuzuar seksualisht.³ Megjithatë në shumë raste dhuna në bazë gjinore ndaj grave me aftësi të kufizuar mbetet e pa raportuar, për shumë arsye, përfshirë: Mungesa e mundësive për të komunikuar; nuk shihen si dëshmitare të besueshme, frika e ndëshkimit, mungesa e mbështetjes etj.⁴ Situata është e njejtë edhe në Kosovë, ku gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara rrallë kërkojnë ndihmë institucionale lidhur me rastet e dhunës.⁵

KORNIZA LIGJORE

¹ Kombet e Bashkuara, Aftësia e Kufizuar dhe Punësimi. Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale: Aftësia e Kufizuar, 2007, në: <https://www.un.org/development/desa/disabilities/resources/factsheet-on-persons-with-disabilities/disability-and-employment.html>

² UN Women, Fakte dhe shifra: Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, 2020, në: <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/women-and-girls-with-disabilities/facts-and-figures#notes>

³ Foundation for European Progressive Studies, Dhuna ne Baze Gjinore Ndaj Grave me Aftesi te Kufizuara, 2018, ne: <https://www.jean-jaures.org/wp-content/uploads/2021/06/Gender-based-violence-against-women-and-girls-with-disabilities.pdf>

⁴ Ibid.

⁵ Rrjeti i Grave te Kosoves, Nga Ligjet ne Vepra: Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunes me baze gjinore ne Kosove, 2021: <https://womensnetwork.org/sq/publications/nga-ligjet-ne-vepra/>

Kosova ka arritur të ndërtojë një kornizë ligjore të zhvilluar për të luftuar dhe parandaluar dhunën në bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, si dhe për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Kushtetuta e Kosovës ka definuar liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe dokumentet ndërkombëtare në nenin 22 par. 6: Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas. Gjithashtu, që nga viti 2020 në këtë nen përfshihet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), si kornizë ligjore me qasje gjithëpërfshirëse për të luftuar dhunën ndaj grave, fokusohet në parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të shkelësve të ligjit nr.03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës veprat e keqtrajtimit, sulmit dhe dhunës ndaj personave respektivisht viktimës së ndjeshme, përkufizohen qartë duke përshkruar elementet e veprës penale të cilat kryhen me veprim ose mosveprim dhe që në tërësi përbëjnë figurën e veprës penale. Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh tri (3) vepra penale në të cilën element i saj është vepra penale ndaj personave/viktimës së ndjeshme si vepra penale 184,185 dhe 186, element i të cilës është vepra penale e kryer ndaj personit të ndjeshem. Bazuar në nenin 184 Sulmi paragrafi 3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me: nënparagrafi 3.1. burgim deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni; ose nënparagrafi 3.2. burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni.⁶ Neni 165 Trafikimi me njerëz paragrafi 1. Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. Lidhur me paragrafin 3. Kushdo që organizon një grup personash për të kryer veprën nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet.⁷ Neni 227 Dhunimi par. 4. Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, lidhur me nënparagrafin 4.7 Kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit fizik apo mendor, paaftësisë ose shtatzënisë.⁸ Në nenin 229 Sulmi seksual paragrafi 3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, lidhur me nënparagrafin 3.7 Kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të

⁶ KODI NR. 06/L-074 PENALI REPUBLIKËS SË KOSOVËS

⁷ KODI NR. 06/L-074 PENALI REPUBLIKËS SË KOSOVËS

⁸ KODI NR. 06/L-074 PENALI REPUBLIKËS SË KOSOVËS

kufizuara mendore apo fizike, ç'rregullimit fizik apo mendor, paaftësisë ose shtatzënisë.⁹ Neni 248 Dhuna në familje paragrafi 3. çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjikë, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/ saj dënohet me gjobë dhe burgim deri në tre (3) vjet.¹⁰

Bazuar në Kodin e Procedurës Penale na jep të drejtën që të paraqesim padrejtësitë ose cenimin e një të mire të shkaktuar me veprim ose mosveprim të personit tjetër.¹¹ Kallëzimi penal është hapi parë dhe në bazë të:

- a) neni 78 Kallëzimi penal nga organet publike paragrafi 1. Të gjitha organet publike detyrohen t'i paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat janë informuar ose për të cilat kanë marrë dijeni në ndonjë mënyrë tjetër,
- b) Neni 79 Kallëzimi penal nga personat paragrafi 1. Çdo person ka të drejtë të kallëzojë veprën penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe detyrohet ta bëjë këtë në rastin kur moskallëzimi i veprës penale paraqet vepër penale,
- c) Neni 80 Kallëzimi penal i paraqitet prokurorit të shtetit paragrafi 1. Kallëzimi penal i paraqitet prokurorit kompetent të shtetit me shkrim, me mjete teknike të komunikimit ose gojarisht.

Në kapitullin e nëntëmbëdhjetë (XIX), janë definuar nocionet e fazave të procedurës në Shqyrtim gjyqësor nga neni 285 deri tek neni 358 I Kodi Procedurës Penale (KPP -së).

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor pason vendimi që merr gjykatësi i procedurës penale si vendim përfundimtar që gjendet në kapitullin e njëzetë (XX), nga neni 359 deri tek neni 373 i Kodi I Procedurës Penale (KPP-së).¹²

SITUATA AKTUALE DHE PROBLEMET EKZISTUESE

Hulumtimet e ndryshme dhe aktivitetet në terren të Organizatës You Can Do tregojnë që një numër shumë i vogël i rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave me aftësi të kufizuara raportohen. Për shembull, gjatë vëzhgimit të organizatës në Ferizaj, është identifikuar vetëm një rast i cili është raportuar, dhe për të cilin është iniciuar kallëzim penal. Gjithashtu, diskutime të ndryshme me përfaqësues të organizatave si dhe Qendrave Burimore tregojnë që nuk ka ankesa lidhur me dhunën fizike, psikike, ose seksuale nga anëtarët ose nxënësit e tyre. Megjithatë, problemi nuk qëndron në faktin që nuk ka raste të dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara, mirëpo rastet nuk raportohen dhe as nuk diskutohen me persona tjerë. Hulumtimet e zhvilluara në Kosovë tregojnë që gratë me aftësi të kufizuara

⁹ KODI NR. 06/L-074 PENALI REPUBLIKËS SË KOSOVËS

¹⁰ KODI NR. 06/L-074 PENALI REPUBLIKËS SË KOSOVËS

¹¹ KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE

¹² KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE

rrallë kërkojnë ndihmë institucionale lidhur me rastet e dhunës.¹³ Kjo mund të jetë për shkak të disa faktorëve, siç janë stigma shoqërore që ndikojnë në këto gra, mungesa e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre, dhe frika nga diskriminimi. Gjithashtu, gratë me aftësi të kufizuara nuk kanë shkathtësi të mjaftueshme komunikuese dhe vetëbesim për t'iu qasur institucioneve për ndihmë. Për shembull, gratë me vështirësi të dëgjimit apo komunikimit mund ta kenë vështirë të kuptojnë të drejtat e tyre dhe të raportojnë rastet.

Diskutime me psikologë të cilët punojnë drejtpërdrejtë me gra me aftësi të kufizuara konfirmojnë që problemi qëndron tek mos-raportimi dhe mungesa e njohurive dhe shkathtësive për të raportuar rastet. Psikologët tregojnë për përvojat e grave me aftësi të kufizuara të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale, fizike, psikike, dhe keqtrajtime të shumta. Gratë kanë treguar se në shumë raste atyre u mungon mbështetja nga familjarët dhe rrethi dhe se në shumë raste ato hasin në vesh të shurdhër, qoftë nga komuniteti, qoftë nga institucionet. Për më tepër, historitë e tyre tregojnë se ato shtypjen, dhunën dhe abuzimin e përjetojnë edhe brenda familjeve të tyre dhe se në shumë raste, ato janë të gjykuara edhe më keq kur ankohen tek të tjerët për keqtrajtimet apo dhunën e ushtruar mbi to nga familjarët, veçanërisht familjarët burra.

Problemi kryesorë qëndron në faktin që këto raste nuk mbërrijnë tek institucionet e drejtësisë në rend të parë.

REKOMANDIMET KONKRETE

- Ministria e Arsimit në Kosovë duhet të zhvillojë pako të reja mësimore që janë të përshtatura për nevojat e personave me aftësi të kufizuara (PAK). Këto module të reja mësimore do të duhet të përdorin metodat më të fundit mësimore, teknologjitë dhe materiale të rëndësishme për të mundësuar studentëve me aftësi të kufizuara një përvojë mësimore të ndryshme nga ajo e parashikuar për studentët e tjerë. Me këtë mundësi të ofruar, studentët me aftësi të kufizuara do të kenë mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre, për të rritur vetëbesimin dhe për të arritur potencialin e tyre maksimal në mësimdhënien e tyre. Kjo do të ndihmonte drejt ngritjes së njohurive dhe vetëbesimit të vajzave me aftësi të kufizuara dhe mund të kontribuojë drejt raportimit të rasteve të dhunës.
- Të rritet numri i psikologëve në qendrat e integritit. Është e rëndësishme që gratë dhe vajzat që kanë aftësi të kufizuara të kenë qasje në mbështetje psikologjike kur kanë nevojë, sidomos në rast se përjetojnë dhunë në bazë gjinore. Kjo do të ndihmonte në përmirësimin e shëndetit mendor të këtyre individëve dhe në përgjithësi në zvogëlimin e problemeve të shëndetit mendor në vend, dhe rritjen e identifikimit dhe raportimit të rasteve të dhunës. Me sa më shumë psikologë në stafet e qendrave të integritit, aq më e mundur është që këta specialistë të kenë më shumë kohë për të punuar me secilin qytetar dhe për të ofruar mbështetje më të personalizuar dhe efektive

¹³ Rrjeti i Grave të Kosovës, Nga Ligjet në Vepra: Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me baze gjinore në Kosovë, 2021: <https://womensnetwork.org/sq/publications/nga-ligjet-ne-vepra/>

- Të mbështeten organizatat që të organizojnë fushata të ndryshme vetëdijesuese në bashkëpunim me institucionet shtetërore për të nxitur trajtimin e barabartë dhe të drejtat e plota të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Këto fushata mund të përfshijnë organizimin e evenimenteve publike, panairëve dhe prezantimeve për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për sfidat dhe mundësitë që hasin personat me aftësi të kufizuara në përditshmërinë e tyre. Me këtë mbështetje, organizatat do të kenë mundësinë të forcojnë kapacitetin e tyre për të ndërmarrë veprime për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta dhe qasje në shërbime publike, arsim dhe punësim.
- Te krijojmë mundësi të barabarta për punësim për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, duke i vlerësuar dhe shfrytëzuar aftësitë e tyre profesionale. Është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë për të kontribuar në shoqëri dhe për të arritur pavarësinë financiare dhe vetëvlerësimin. Nëse ata kanë mundësi të punojnë në një ambient të përshtatshëm, ata mund të jenë një burim i vlefshëm i aftësive dhe kontributit në ekonomi. Për të ofruar mundësinë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara, rekomandojmë që të ndërmerren disa hapa. Një hap i rëndësishëm është rritja e ndërgjegjësimit në mesin e punëdhënësve dhe shoqërisë në përgjithësi për të drejtat dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara. Të krijojmë fushata të ndryshme vetëdijesuese për trajtimin e barabartë të personave me aftësi të kufizuara në punë dhe t'i inkurajojmë punëdhënësit të shfrytëzojnë mundësitë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara bazuar në aftësitë e tyre profesionale.
- Rekomandojmë që Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë të ndërmarrë hetime të plota dhe të pavarura në rastet e raportuara të abuzimit seksual, dhunës fizike dhe psiqike të grave me aftësi të kufizuara. Është e rëndësishme që të ndiqen proceset gjyqësore me rigorozitet dhe pavarësi për të siguruar drejtësinë dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre viktimave. Rekomandojmë gjithashtu që të përmirësohet bashkëpunimi midis institucioneve për të siguruar që hetimet dhe proceset gjyqësore të jenë të ndershme dhe efektive. Ministrinë e Drejtësisë i rekomandojmë që të përmirësojë edukimin për casjen ndaj personave me aftësi të kufizuara nga ana e prokurorise, avokatëve dhe personelit të gjykatave në lidhje me të drejtat dhe nevojat e grave me aftësi të kufizuara në proceset gjyqësore të këtyre rasteve.
- Ministria e Punëve të Brendshme të zhvillojë trajnime të specializuara për policët dhe zyrtarët e shtetit në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për menaxhimin e situatave të emergjencës ku janë të prezentuar këta persona.
- Të krijohen grupe pune në kuadër të organizatave joqeveritare dhe shtetërore për të zhvilluar fushata të informimit dhe sensibilizimit në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe për të promovuar ndryshimet legjislative për rritjen e mbrojtjes së tyre.
- Të ofrohen trajnime dhe ndihmë për të rritur vetëdijësimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për të drejtat e tyre dhe për të ndihmuar ato të identifikojnë dhe të denoncojnë raste të mundshme të dhunës dhe keqtrajtimin.
- Të ofrohen mundësi për të denoncuar dhe për të raportuar raste të dhunës apo abuzimit, duke iu garantuar mbrojtja dhe ndihma e nevojshme në procesin e raportimit dhe hetimit të këtyre rasteve.